



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:087054

Datë: 31.05.2022

Numri i dokumentit: 03081545

PPP.nr.18/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit C.F.F LLC me seli ne P., kundër debitorëve NPT A-R me adresë në Fsh G. K-Istog përfaqësuar nga L.R.1 dhe L.R.2 nga Fsh G. K-Istog, te cilët sipas autorizimit i përfaqëson D. Z. av në P., për shkak të borxhit në shumë prej 12,104.18 €, pas prapësimit te ushtruar nga ana e debitorët, me dt.12.04.2022 kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, gjykata jashtë seance me dt.31.05.2022 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË prapësimi i debitorëve NPT A-R me adresë në Fsh. G. K-Istog, përfaqësuar nga L.R.1 dhe L.R.2 nga Fsh. G. K-Istog, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.144/2022 të dt.28.03.2022, për shkak të borxhit në shumë prej 12,104.18€, si i PA AFATSHËM.

A r s y e t i m

Kreditori, C.F.F LLC me seli ne P., ka ushtruar propozimin për përmbarim te përmbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorëve NPT A-R me adresë në Fsh G. K-Istog përfaqësuar nga L.R.1 dhe L.R.2 nga Fsh G. K-Istog, për borxh në shumë prej 12,104.18, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga pranimi i urdhrit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare të debitorit, sekuestrimi regjistrimi dhe shitja e sendeve te luajtshme dhe te paluajtshme, e shuma e mjeteve të transferohet në llogari te kreditorit, të gjitha të specifikua në propozimin për përmbarim të datës 28.03.2022.

Përmbaruesi privat me urdhër P.nr.144/2022 të dt.28.03.2022, e ka lejuar propozimin për përmbarim.

Pas lejimit të përmbarimit me urdhër përmbarimor, të njëjtin përmbaruesi privat ja ka dorëzuar debitorëve të cilin e kanë pranuar me datë 04.04.2022 me paralajmërimin se pala e pakënaqur ka të drejt të paraqes prapsim në afat 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit.

Debitorët, NPT A-R me adresë në Fsh G. K-Istog përfaqësuar nga L.R.1 dhe L.R.2 nga Fsh G. K-Istog, përmes te autorizuarit kanë ushtruar prapsim me dt:12.04.2022, kundër urdhrit për përmbarim përmbarimit P.nr.144/2022 të dt.28.03.2022, me te cilën është lejuar përmbarim sipas propozimit të kreditorit C.F.F LLC me seli ne P..

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se debitori, nuk ka vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar për paraqitjen e prapsmit kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, andaj gjykata, bazuar ne nenin 70 te Ligjit të Procedurës Përmbarimore i cili thotë citoi “Prapësimi duhet ti paraqitet gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues” e në rastin konkret debitorët NPT A-R me adresë në Fsh. G. K-Istog, përfaqësuar nga L.R.1 dhe L.R.2 nga Fsh. G. K-Istog, e kanë pranuar propozimin për përmbarim të lejuar me urdhër me datë 04.04.2022 dhe afati ka filluar të ecë nga data 23.04.2021 ndërsa prapësimin e kanë parashtruar me datë 12.04.2022, e nga pranimi i propozimit të përmbarimit e deri me ditën e paraqitjes së prapësimit kanë kaluar 8 ditë, e në rastin konkret afati i fundit për ngritjen e prapësimit ka qenë data 11.04.2022, ashtu që prapësimi i debitorëve konsiderohet si I PA AFATSHËM.

Andaj, nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 70, 73.3 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përmbarimore), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.18/2022, dt.31.05.2022

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në P.. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.